

VENDIM
Nr. 135, datë 20.2.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME¹**

(Ndryshuar me VKM nr.152, datë 13.3.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë, si organ qendror blerës, për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të spitaleve publike në varësi të saj, për blerjen e medikamenteve dhe materialeve mjekësore.

2. Ministria e Shëndetësisë të prokurojë fondin limit, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuar për çdo spital, për secilin nga artikujt.

3. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda muajit shkurt, të dërgojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, si organi qendror blerës, të dhënat, teknike e sasiore dhe fondin përkatës për çdo artikull që prokurohet.

4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit;

a/1) të lidhë kontrata të posaçme me prodhues të barnave (Managed Entry Agreements ose MEA), në kushtet e nenit 6, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar, në këto raste të veçanta:

i) Kur bari mund të sigurohet vetëm nga një prodhues, i cili zotëron të drejtat ekskluzive mbi atë bar;

ii) Kur përdorimi i teknologjisë së barit mund të rrisë efikasitetin e trajtimit të pacientëve në spitalet publike dhe kur bari është alternativë e vetme për një sëmundje ose indikacion të caktuar;

iii) Për sasi të garantuara bari, me çmim më të ulët se ai i deklaruar, miratuar nga ministria;

b) të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për prokurimet publike, që do të zhvillojë si organ qendror blerës;

c) të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore me ligjin dhe standardet në fuqi;

ç) të shqyrtojë dhe të miratojë specifikimet teknike, të dërguara nga autoritetet kontraktore. Nëse gjykohet se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimet publike ose mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, organi qendror blerës kryen rishikimin e specifikimeve teknike, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

d) të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me

¹ VKM nr. 135, datë 20.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.26, 7 mars 2013.

VKM nr. 152, datë 13.3.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.41, 27 mars 2018.

standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave, të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

dh) të bashkërendojë punën për testimin e tregut për përlogaritjet e të dhënave sasiore për mallrat, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit. Në këto raste, organi qendror blerës vë në dijeni autoritetet kontraktore për ndryshimet e bëra;

5. Organi qendror blerës, në rast se autoritetet kontraktore kanë kërkesa, pasi është bërë publikimi i njoftimit të kontratës së prokurimit, verifikon arsyet e vonesës dhe vendos për shpalljen ose jo të procedurës së re të prokurimit për këto kërkesa.

6. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojë autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, për zbatimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha